



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 56, Datë 29.10.2007

“PËR DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS NË MBËSHTETJE TË V.K.M.NR.434 DT. 13 07.2007 “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DT.07.11.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE , ”PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE “ TË NDRYSHUAR

Ne mbështetje të Ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin edhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore “, neni 32/ç, të Ligjit Nr.8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës “, të Ligjit Nr.8935 datë 12.09.2002, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës , neni 6, gërma “a”, gërma “b” dhe gërma “c”, të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i Nëpunësit Civil “, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 434 datë 13.07.2007, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.551, datë 07.11.2002” të Këshillit të Ministrave , “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të Qeverisjes Vendore , për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore “, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë nivelet e pagave për çdo funksion të Njësive Bashkiake me numër banorësh nga 20001 deri në 50000, sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagës për çdo funksion të Njësive Bashkiake me numër banorësh mbi 50001, sipas lidhjes Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të miratojë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak të Njësive Bashkiake në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Njesisë Bashkiake.
4. Efektet financiare të këtij Vendimi fillojnë më 1 Korrik të vitit 2007 dhe do të përballohen nga fondet e grantit të akorduara nga Pushteti Qëndror të planifikuara për rritjen e pagave në buxhetin e shtetit të këtij viti, sipas tabelës Nr.1 pjesë përbërese e këtij vendimi.
5. Vendimi Nr. 40, datë 17.07.2006 i Këshillit Bashkiak “Për nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Bashkiake të Tiranës “, shfuqizohet.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Njësitë Bashkiake.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R